



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.2.2021, ora 15:20

Drejton mbledhjen

Ilir Beqaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarresi), dhe KFW Frankfurt AM Main (KFW), për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 80 000 000 (tetëdhjete milionë) euro. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Ilir Beqaj, Halil Jakimi, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama dhe Halit Valteri.

Mungojnë:

Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Dritan Bici dhe Besnik Baraj.

Të ftuar:

Flauers Shoshi – Zëvendës drejtor i AKUM-it

Jovan Gjika – Përfaqësues i AKUM-it

Elona Mistrovica – Përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Ilir Beqaj – Mirëdita, kolege dhe kolegë!

Ndjesë për këtë njoftim të papritur, por meqenëse dje u miratua kalendari dhe ky projektligj është përcaktuar të jetë në seancë të hënën, do të na duhet ta diskutojmë dhe ta miratojmë sot, që pastaj t'i hapim rrugën komisionit përgjegjës të punojë dhe shprehet, duke respektuar afatin e përfundimit të diskutimeve para ditës së seancës.

Ora është 15:19, datë 18 shkurt 2021. Sot do të diskutojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarresi), dhe KFW Frankfurt AM Main (KFW), për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro.

Kjo është nismë e Këshillit të Ministrave. Të pranishëm në mbledhje kemi përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zotin Flauers Shoshi, zëvendës drejtor i AKUM-it, dhe zonjën Elona Mistrovica nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

I kemi në linjë përfaqësuesit e ministrive? Zonja Mistrovica?

Elona Mistrovica – Po, përshëndetje!

Ilir Beqaj – Përshëndetje!

Për të mos ngarkuar kolegët, në këtë rast relator është deputeti Ilir Beqaj, megjithëse koha ishte shumë e shkurtër.

Fillimisht fjalën e kanë përfaqësuesit e qeverisë për të prezantuar marrëveshjen. Kush do ta fillojë prezantimin, zonja Mistrovica apo zoti Shoshi?

Fjala për ju zoti Shoshi.

Flauers Shoshi – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve! Unë jam Flauers Shoshi, zëvendës drejtor i AKUM-it. Qëllimi i këtij programi (bëhet fjalë për infrastrukturën bashkiake, që është loti V), është të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si dhe përmirësimin e performancës të shoqërive të ujësjellës-kanalizime të përfshira në këtë program.

Në këtë program janë përfshirë 8 bashki: bashkia e Shkodrës, e cila kap qendrën e qytetit me një popullsi prej rreth 20 mijë banorë; bashkia e Lezhës, ku kemi edhe pjesën e Shëngjinit dhe dy fshatra të tjerë me një popullsi aktuale dhjetë mijë banorë, por që gjatë

verës pesëfishohet; Kamzës, Beratit, Kuçovës, ku përfundon i gjithë ujësjellësi, Elbasanit, Fierit dhe Vlorës.

Dua të theksoj se në disa qytete, përveç investimeve që do të bëhen nëpërmjet KFW-së, bankës gjermane, aktualisht ne po ecim para edhe me investimet tona dhe në shumë qytete, si Vlora, Elbasani, Berati dhe Fieri, në harmoni me investimet e buxhetit të shtetit, këto investime mbyllen 100% dhe në këto qytete kthehet furnizimit me ujë 24 orë në 24.

Ky projektligj do të mbulohej nëpërmjet huas. Përcaktimet që kemi në projektligj do të synojnë kryesisht ndërhyrjet në përmirësimin e aksesit dhe qëndrueshmëri më të madhe sa i përket trashëgimisë kulturore, pasurive natyrore, si dhe përmirësimit të infrastrukturës në të gjithë territorin e vendit, kjo në kuadër të planeve zhvillimore dhe kriterëve të lejueshme të programeve.

A doni të flas për fazat në të cilat do të implementohet ky program?

Ilir Beqaj – Fol për atë që mendon se duhet të dinë deputetët.

Flauers Shoshi – Dakord.

Faleminderit!

Ky program kalon në dy faza.

Faza përgatitore konsiston në planifikimin dhe specifikimin e investimeve nëpërmjet përditësimit dhe hartimit të studimeve të fizibilitetit nga konsulentët teknikë. Kjo fazë e programit ka përfunduar brenda muajit tetor 2020 me dorëzimin e studimeve përfundimtare të fizibilitetit.

Faza e zbatimit konsiston në zbatimin e investimeve të planifikuara nëpërmjet studimeve të fizibilitetit. Gjatë kësaj faze konsulentët teknikë do të hartojnë projektet e detajuara teknike, ku përgatitin dokumentet e tenderimit të punimeve, si dhe mbikëqyrjen në terren të zbatimit të punimeve.

Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve do të marrin mbështetje institucionale për forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës për të arritur kriteret e programit, të vendosur si kusht paraprak për të proceduar me hapat e zbatimit të projektit, si dhe për të pasur një operim të qëndrueshëm të investimeve. Kjo bën që të kemi një përmirësim të eficiencës të të gjitha ndërmarrjeve për sa u përket bashkive.

Në kuadër të këtij financimi në formë kredie të qeverisë federale gjermane do të financohen investimet e lidhura kryesisht me rehabilitimin e ujësjellës-kanalizimeve, në të cilat do të bëhet përmirësimi i furnizimit me ujë, i tuneleve të kanalizimeve, si dhe shërbimi i konsulencës teknike.

Shumica e shërbimeve të konsulencës teknike konsistojnë në hartimin e projekteve të detajuara teknike, të cilat janë: rehabilitimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, përgatitja e dokumenteve të tenderëve, punime, si dhe mbikëqyrje të zbatimit të punimeve në terren.

Në qoftë se do të keni ndonjë pyetje, të nderuar deputetë, jam i gatshëm të kaloj në detaje.

Ilir Beqaj – Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave a mund të na shpjegojnë diçka për termat e huas? Zonja Mistrovica?

Elona Mistrovica – Referuar termave financiarë të kësaj huaje, bëhet fjalë për ...

Ilir Beqaj – Jeni shumë larg mikrofonit.

Afrojeni pak, ju lutem!

Elona Mistrovica – ... me interes të përcaktueshëm në momentin e disbursimit, por një normë reference, e referuar nga kreditori, në momentin e negocimit, ka qenë 0,41%, që është norma referencë IKAP-Euro, plus një marzh i fiksuar nga KfW në vlerën 0,66%. Pra, në total, kjo vlerë interesi është 1,07%. Kemi të bëjmë me një tarifë menaxhimi me 0,5% të shumës së huasë dhe një komision angazhimi për 2 vjetët e para të kredisë në vlerën 0,125%, ndërsa pas 2 vjetësh ky komision angazhimi shkon në 0,25%. Maturimi i kësaj kredie është 15 vjet, me një periudhë *grace* prej 5 vjetësh.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Ka pyetje nga kolegët?

Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Kam vetëm një pyetje të shkurtër, sepse nuk e dëgjova mirë.

Sa është komisioni i angazhimit në 2 vjetët e parë?

Ilir Beqaj – Zonja Mistrovica, e dëgjuat pyetjen?

Elona Mistrovica – Me sa duket kam probleme me linjën.

Mund ta bëni edhe një herë pyetjen?

Ilir Beqaj – Edhe një herë pyetjen, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Sa është komisioni i angazhimit në 2 vjetët e parë, sepse nuk e dëgjuam?

Elona Mistrovica – Në 2 vjetët e parë kemi një komision angazhimi prej 0,125%.

Arben Pëllumbi – 0,125%.

Dakord.

Faleminderit!

Ilir Beqaj – Ka pyetje të tjera?

Atëherë, kam unë dy pyetje, zoti Shoshi.

Në këtë fazë, meqenëse ju thoni se në tetor keni bërë studimin e fizibilitetit, 80-milionëshi, mund të na thoni si është i ndarë, sipas bashkive? Sa është konsulenca? Sa do të jenë punime civile?

Flauers Shoshi – Patjetër, zoti kryetar.

Qyteti i Shkodrës, që do të ketë sistemin e tubacionit, i cili do të ndërtohet nga hyrja e qytetit, deri në impiantin në afërsi të Muriqanit, me një distancë rreth 7,5 kilometër, do të ketë një vlerë prej rreth 17,5 milionë eurosh; në Fier do të ketë një vlerë prej 13,5 milionë euro; në Elbasan do të ketë një vlerë prej 17 milionë eurosh; në Vlorë do të ketë një vlerë prej 18 milionë eurosh, e cila do të shkojnë për ujësjellësin. Kjo duhet të theksohet për sa i përket qytetit të Vlorës, pasi me këtë investim e mbyllim qytetin e Vlorës pothuajse 100% për sa i përket furnizimit me ujë. Në Kamëz do të ketë një vlerë prej 10 milionë eurosh, ndërsa sa në Lezhë do të ketë një vlerë prej 17 milionë eurosh.

Ilir Beqaj – 17 apo jo?

Flauers Shoshi – po 17 milionë euro.

Ilir Beqaj – Po Kuçova dhe Berati?

Flauers Shoshi – Kuçova dhe Berati janë një pjesë: 10,5 milionë euro në qytetin e Beratit...*(Nuk dëgjohet.)*

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Jovan Gjika – Kam diçka tjetër për të shtuar, zoti kryetar.

Ilir Beqaj – Po, urdhëroni!

Afrohuni pak te mikrofonin ju lutem, se zëri mezi dëgjohet.

Jovan Gjika – Për të ndihmuar në sqarimin e shifrave, dua të them se marrëveshja e huas është e shoqëruar me anekset përkatëse dhe aneksi 3 është buxhetimi. Aty jepen të dhënat e detajuara se si ndahen buxhetet në investime dhe në shërbime konsulence. Gjithsesi, ky program në total shkon në vlerën e 130 milionë eurove, ku vetëm 80 milionë euro janë kredi, ndërsa pjesa tjetër është grant që jepet nga qeveria zvicerane, Bashkimi Europian nëpërmjet IPA 2018, si dhe grantet e qeverisë gjermane. Grantet mbulojnë konsulencat, kurse kredia shkon për investime për të pasur rentabilitet, për të pasur normë vlerësimi. Ky është parimi i programeve me KfW-në që me grantet do të mbulohen shërbimet e konsulencës, kurse investimet janë me kredi. Por edhe tek investimet ka kombinime, pasi, kryesisht, kredia do të shkojë për investimet e ujësjellësve që kanë rentabilitet më të mirë se sa kanalizimet, kurse kanalizimet dhe impiantet synohet që të financohen me grantet që vijnë nga IPA 2018 dhe qeveria zvicerane.

Ilir Beqaj – Atëherë, po më detyroni të bëj disa pyetje të tjera.

Ju thoni se i gjithë programi është 130 milionë euro. Shuma 130 milionë është vetëm për këto bashki, apo përfshihen edhe bashki të tjera?

Jovan Gjika – Për të njëjtat bashki.

Ilir Beqaj – Atëherë, nuk besoj se i gjithë 50-milionëshi i grantit është për asistencë teknike, apo jo?

Jovan Gjika – Jo.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Unë dua q t'i thoni edhe një herë shifra: sa është investimi në radhë sipas bashkive, nuk ka rëndësi në janë kredi apo grante, sepse unë dua të di totalin?

Jovan Gjika – Është pikërisht aneksi i marrëveshjes që iu referova, aneksi 3, ku është buxhetimi.

Ilir Beqaj – Ma thuaj, se ju e keni hartuar.

Sa kredi plus grand ka në Shkodër, ose në Berat, apo në Fier?

Jovan Gjika – Investimet në ujësjellës janë nga kredia.

Ilir Beqaj – Po më thua që i gjithë programi i investimit, infrastruktura bashkiake 5, është 130 milionë për këto bashki, pra për këto të teta, nuk ka rëndësi nëse është grand apo kredi. Sa është investimi që do të bëhet sipas bashkive?

Jovan Gjika – Ajo që tha Flauersi.

Ilir Beqaj – Pra, shifrat që thatë qëparë, 17, 18 janë për shumën 130, apo për shumën 80, se nuk e bëmë ne provën?

Arben Pëllumbi – Shifrat janë për këtë 130-n, zoti kryetar, se këto bëjnë 104 milionë. *(Nuk kuptohet)*...vetëm për investime dhe janë në total kredi dhe grand.

Ilir Beqaj – E kuptova, faleminderit! 17.5 janë të dyja bashkë.

Nëse nuk ka pyetje të tjera hapim procedurën e votimit.

Kush është dakord në parim me miratimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe KFW Frankfurt am Main (KFW), për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 80 000 000 (tetëdhjete milionë) euro"?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Sipas tekstit që keni përpara.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Zoti Marto, abstenoni, apo jeni dakord?

Andrea Marto – Dakord.

Ilir Beqaj – Dakord

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet

E hedhim në votë në tërësi.

Kush është dakord për miratimin në tërësi të projektligjit? Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, kolegë deputetë!

Bashkëqytetarët tanë të bashkive Shkodër, Lezhë, Kamëz, Berat, Kuçovë, Elbasan,
Fier dhe Vlorë t'i gëzojnë investimet e reja për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve!

Faleminderit!

Edhe një herë ndjesë për prishjen e agjendës së pasdites!

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA